

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6596
E mërkurë, 4 maj 2022
çmimi 0.40

Scholzi pret në Berlin Kurtin, Vuçiqin dhe Lajçakun

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTITË OPOZITARE NË KOSOVË THONË SE TËRHEQJA NGA GAZSJELLËSI AMERIKAN RREZIKON PARTNERITETIN ME SHBA-në

FAQE 4-5

OPOZITA: REFUZIMI I PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT AMERIKAN, GABIM STRATEGJIK I QEVERISË



Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, kanë theksuar të martën se refuzimi i projektit të gazsjellësit amerikan ka qenë gabim strategjik i Qeverisë së Kosovës. Ata kanë thënë se kjo qeveri duhet të japë përgjegjësi dhe llogari se pse ke refuzuar rreshtimin e Kosovës me ShBA-në. Ndërkaq profesori universitar Valon Murati ka thënë se janë disa projekte strategjike të cilat nuk kanë çmim dhe as nuk maten me studime fizibiliteti. Sipas tij, një i tillë është edhe projekti amerikan i gazit të lëngshëm natyror (LNG)

AKTUALE



**ZELENSKY I KËRKON SHOQPËRISË
TË MOS LEJOJË TURISTË E ANIJE
RUSE** F. 6

**BERISHA KONFIRMON
KANDIDATURËN PËR KREUN
E PD-SË: NUK KAM RIVALË** F. 6

**SLLOVAKIA DHE HUNGARIA S'I
MBËSHËTETIN SANKSIONET MBI
ENERGJINË RUSE** F. 2

EKONOMI



**GATI 5 MILIARDË EURO
KURSIME NË KOSOVË:
KU SHKOJNË KËTO PARA?** F. 7

SPORT



**LIVERPOOLI KUALIFIKOHET
NË FINALE** F. 10

**AGK-ja: Politikanët
të mos sulmojnë
apo nxisin urrejtje
ndaj gazetarëve** FAQE 3



**MBROJTËSIT E ISH-UDHËHEQËSVE
TË UÇK-SË NË HAGË IA PARAQESIN
KURTIT KËRKESAT DHE ANKESAT
PËR PROCESIN GJYQËSOR**

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Slovakia dhe Hungaria s'i mbështetin sanksionet mbi energjinë ruse

BRUKSEL, 3 MAJ - Slovakia dhe Hungaria thanë se nuk do t'i mbështetin sanksionet kundër energjisë ruse, përfshirë ato mbi importin e naftës. Bashkimi Evropian ka dhënë shenja se mund të propozojë sanksione të tilla, për të ndëshkuar Rusinë, për shkak të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës. Slovakia dhe Hungaria thanë se janë shumë të varura nga nafta ruse dhe se nuk kanë alternativa të menjëhershme. Ministri slovak i Ekonomisë, Richard Sulik, tha se do të duheshin vite që rafineria e

vetme e vendit të tij, Slovaft, të kalonte nga nafta bruto ruse në një lloj tjetër naftë. Ministri i Jashtëm i Hungarisë, Peter Szijjarto, tha se vendi i tij nuk do të votojë për sanksione që "do ta bënin të pamundur transportin e gazit natyror ose të naftës nga Rusia në Hungari". Szijjarto tha se do të ishte e pamundur që Hungaria dhe ekonomia e saj të funksiononin pa naftën ruse. "Çështja është e thjeshtë: furnizimi me energji i Hungarisë nuk mund të rrezikohet, sepse askush nuk

mund të presë që çmimi i luftës të paguhet nga hungarezët", tha Szijjarto gjatë një vizite në Kazakistan. Propozimet e reja të Komisionit Evropian mund të përfshijnë një embargo me faza ndaj naftës ruse. Njëzet e shtatë vendet anëtare ka të ngjarë t'i fillojnë diskutimet më 4 maj, por mund të duhen ditë që masat të miratohen dhe të hyjnë në fuqi. Shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, tha të martën se Komisioni Evropian është afër propozimit të sanksioneve të reja dhe se



paketa do t'i përfshijë importet e naftës. Bashkimi Evropian merr çerekun e naftës së tij nga Rusia, ashtu si edhe 40 % të

gazit. Shtetet e Bashkuara, që kanë varësi më të vogël nga Rusia, kanë ndaluar tashmë importin e naftës dhe gazit nga ky vend.

Putin: Perëndimi ta ndalë furnizimin e Ukrainës me armë

MOSKË, 3 MAJ - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, i tha homologut francez Emmanuel Macron se Perëndimi duhet ta ndalojë furnizimin e Ukrainës me armë. Dy liderët biseduan të martën përmes telefonit. Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe vendet e tjera janë duke e ndihmuar Ukrainën me armatim për t'iu kundërvënë pushtimit rus. Duke i akuzuar forcat e Ukrainës për "krimeve të luftës", Putini tha se "Perëndimi mund të ndihmojë në ndalimin e këtyre mizorive, duke ushtruar presion të duhur mbi autoritetet e Kievit, si dhe duke ndaluar furnizimin me armë të Ukrainës".



Sipas një komunikate të lëshuar nga Kremli, Putini, gjithashtu, tha se Kievi nuk është i gatshëm për "bisedime serioze" për t'i dhënë fund konfliktit. "Pala ruse është

ende e hapur për dialog", citohet t'i ketë thënë Putini Macronit. Presidenca franceze tha se Macroni ka përsëritur thirrjet për Rusinë që t'i japë fund

luftës në Ukrainë, ndërsa Putini i ka kërkuar që ta lejojë evakuimin e civilëve nga fabrika e rrethuar e çelikut Azovstal në qytetin e Mariupolit.

Në dy ditët e fundit mbi 150 civilë janë evakuuar nga bunkerët nën Azovstal, pas më shumë se dy muajsh të bllokuar atje. Së paku edhe dhjetëra të tjerë besohet se mbeten ende në bunkerë. I gjithë Mariupoli, përveç zonës rreth Azovstalit, është nën kontrollin e forcave ruse. Macroni është një nga udhëheqësit e paktë perëndimorë që bisedon me Putinin, qëkur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, në përpjekje për të gjetur një zgjidhje për konfliktin. Nga lufta në Ukrainë janë vrarë mijëra njerëz, ndërsa janë zhvendosur mbi 13 milionë.

OBSH paralajmëron për "epideminë" e obezitetit në Evropë

GJENEVE, 3 MAJ - Organizata Botërore e Shëndetësisë tha se "epidemia" e mbipeshës dhe obezitetit shkakton mbi 1.2 milion vdekje në vit në të gjithë Evropën. Në raportin e publikuar të martën, OBSH-ja tha se normat e obezitetit në rajon janë rritur për 138 për qind në pesë dekadat e fundit. Gati një e katërta e të rriturve tani janë obezë në Evropë - më shumë se në çdo rajon tjetër, përveç Amerikës, ka njoftuar OBSH-ja. "Përqindjet e mbipeshës dhe obezitetit kanë

arritur përmasa epidemike në të gjithë rajonin dhe janë duke u përshkallëzuar", ka njoftuar Zyra në Evropë e OBSH-së. "Rritja e indeksit të masës trupore është faktor kryesor rreziku për sëmundjet jo të transmetueshme, përfshirë kancerin dhe sëmundjet kardiovaskulare", citohet në raport drejtori rajonal i OBSH-së, Hans Kluge. Obeziteti shkakton së paku 13 lloje të ndryshme të kancerit dhe ka të ngjarë të jetë përgjegjës për së paku 200 000 raste të reja të kancerit në vit,

thuhet në raport. "Kjo shifër do të rritet edhe më në vitet e ardhshme", paralajmëroi OBSH-ja. Mbipeshja dhe obeziteti vlerësohet se shkaktojnë më shumë se 1.2 milion vdekje në vit, duke përbërë më shumë se 13 për qind të vdekjeve në rajon, thuhet në raportin e OBSH-së. Organizata bëri thirrje për ndryshimin e politikave për ta parandaluar obezitetin dhe për të promovuar stile të shëndetshme të jetesës. Si



shembuj, ajo përmendi taksimin e pijeve me sheqer dhe

subvencionimin e ushqimeve të shëndetshme.

Mbrojtësit e ish-udhëheqësve të UÇK-së në Hagë ia paraqesin Kurtit kërkesat dhe ankesat për procesin gjyqësor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MAJ - Në ditën kur u njoftua nga Gjykata Speciale se Zyra e Prokurorit Special ka dorëzuar aktakuzën e ndryshuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bashkëbiseduar me të gjithë avokatët dhe bashkavokatët e ekipeve mbrojtëse të ish-udhëheqësve të UÇK-së të akuzuar para Dhomave të Specializuara në Hagë.

Sipas njoftimit të qeverisë, takimi u mbajt online dhe zgjati gati dy orë dhe gjatë tij u diskutuan kërkesat e ekipeve mbrojtëse për Qeverinë e Republikës së Kosovës. "Takimi u mbajt si rezultat i nevojës për të diskutuar dhe adresuar kërkesat e bëra nga ekipet mbrojtëse: procesi i stërzgatur i mbajtjes në paraburgim të të akuzuarve, mosrespektimi i praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mungesa e përkthimeve dhe, në veçanti, mosmarrja në konsideratë e okupimit dhe krimeve të

Serbisë në Kosovë gjatë viteve '90", është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri Kurti propozoi që takimet e tilla të vazhdojnë e të jenë të rregullta. "Të gjitha ekipet u shprehën tejet mirënjohëse për mundësinë e diskutimit me kryeministrin Kurti dhe shprehën falënderim për faktin se Qeveria e Kosovës po tregon interesim dhe angazhim në lidhje me procesin para Dhomave të Specializuara", është theksuar në njoftimin e qeverisë.

Dorëzohet aktakuzë e re për Thaçin dhe të tjerët

Më 29 prill Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit.

Prokuroria po pretendon se katër të akuzuarit kanë kryer krime luftime edhe në Gjilan, Budakovë e Seminishtë.

Në njoftimin për medie thuhet se aktakuza e re kundër Thaçit, Veselit, Krasniqit e Selimit pritet të rëndohet me akuza të reja që



u referohen krimeve që pretendohet të jenë kryer në fshatrat e Suharekës dhe në Gjilan. "Midis 4 korrikut 1998 dhe shtatorit 1998 dhe më ose rreth 28 ose 29 prill në vitin 1999 disa pjesëtarë të UÇK-së ndaluan së paku dymbëdhjetë persona pa një proces të rregullt ligjor ligji në Budakovë. Të arrestuarit, të cilët u mbajtën për periudha të ndryshme kohore, u ndaluan fizikisht dhe u

mbajtën në dhoma të mbyllura dhe nën mbikëqyrjen e rojeve të armatosura. Menjëherë pas ndalimit në Budakovë, të paktën një nga të arrestuarit u transferua në Semetishtë dhe, po ashtu, u mbajt aty deri rreth orës 19:00 deri më 20 gusht 1998. Në këto ndalime u përfshinë shumë anëtarë të UÇK-së, duke përfshirë pjesëtarët e Brigadës 123 në Zonën Operative të

Pashtrikut...", thuhet në aktakuzë.

Pas kësaj, gjykatësi i procedurës paraprake, pasi ka konfirmuar akuzat e reja, ka caktuar 10 majin si datë kur të akuzuarit do të dalin para gjykatës. Thaçi pritet të dalë nga ora 10:00 deri në 10:45, Veseli nga ora 11:15 deri në orën 12:00, Krasniqi nga ora 14:00 deri në 14:45 dhe Selimi nga ora 15:15 deri në orën 16:00.

AGK-ja: Politikanët të mos sulmojnë apo nxisin urrejtje ndaj gazetarëve

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Të martën është shënuar Dita Botërore të Lirisë së Shtypit. Kjo ditë shënohet që nga viti 1993, e vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e cila shërben për t'ua përkujtuar qeverive nevojën e respektimit të përkushtimit të tyre për lirinë e shtypit. 3 Maji, gjithashtu, është një ditë reflektimi në mesin e profesionistëve të medieve për lirinë e shtypit dhe etikën profesionale.

Për nder të shënimit të kësaj dite, Bordi i Asociacionit i Gazetarëve të Kosovës nëpërmjet një deklarate të përbashkët ka adresuar shqetësimet për qeverinë, institucionet e sundimit të ligjit dhe aktorët e tjerë relevantë, për ta ngritur zërin e tyre ndaj cenimit të lirisë së medias, sigurisë së gazetarëve, gjuhës denigruese ndaj gazetarëve dhe ndikimit të saj në besimin në medie.

Këtë deklaratë bordi i AGK-së e ka adresuar përmes një konference për shtyp që është mbajtur pranë qeverisë.

Kryetari i bordit i AGK-së, Xhemajl Rexha, ka thënë se ndër

vite gazetarët dhe mediet e Kosovës kanë luajtur rolin e tyre primar për informimin e publikut dhe mbajtjen përgjegjës të njerëzve në pushtet që kanë udhëhequr e udhëheqin vendin. "Ndodh rrallë që politikanët të jenë të kënaqur me punën e medieve, dhe gazetarët nuk kërkojnë dhe nuk presin një gjë të tillë. Por, ajo që presin është që njerëzit në pushtet ta njohin rolin dhe profesionin e gazetarit dhe ta respektojnë atë", ka thënë ai.

Rexha ka theksuar se sulmet e vazhdueshme dhe të orkestruara nga pushteti aktual, shpeshherë të bëra me gjuhë 'politikisht në rregull', janë duke e degraduar profesionin e gazetarit si asnjëherë më parë. "Kjo sjellje, në kombinim me mbylljen e institucioneve dhe mostransparencën që ka mbizotëruar gjatë tërë vitit të kaluar, e bën punën e gazetarit shumë të vështirë. Tentativa e politikanëve që skandalet të fshihen duke sulmuar gazetarët me narrativën e mirorkestruar që 'ata shpifin, mos iu besoni', është e rrezikshme dhe i bën gazetarët të duken kinse janë armiku i vendit. Kur kjo narrativë bëhet e



përditshme, atëherë ajo përbën kërcënim direkt për sigurinë e gazetarëve. Në vend të nxitjes së urrejtjes ndaj gazetarëve, fuqia politike e pushtetarëve sot duhet të përdoret për ta përmirësuar ambientin e të bërit gazetari duke adresuar fillimisht të gjitha kritikën që janë dhënë nga

raporte kredibile ndërkombëtare", ka thënë ai, duke shtuar se politikanët duhet ta ndalin menjëherë bojkotimin e medieve. "Në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit ne kërkojmë që politikanët ta ndalin menjëherë bojkotimin e medieve, të japin

llogari rregullisht, ta respektojnë legjislacionin për qasje në dokumente publike, të mos sulmojnë apo nxisin urrejtje ndaj gazetarëve, dhe të krijojnë kushte për luftimin efektiv të pandëshkueshmërisë së sulmeve ndaj gazetarëve", është shprehur Rexha.



PARTITË OPOZITARE NË KOSOVË THONË SE TËRHEQJA NGA GAZSJELLËSI AMERIKAN RREZIKON PARTNERITETIN ME SHBA-NË

Opozita: Refuzimi i projektit të gazsjellësit amerikan, gabim strategjik i qeverisë

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, kanë theksuar të martën se refuzimi i projektit të gazsjellësit amerikan ka qenë gabim strategjik i Qeverisë së Kosovës. Ata kanë thënë se kjo qeveri duhet të japë përgjegjësi dhe llogari se pse ke refuzuar rreshtimin e Kosovës me ShBA-në. Ndërkaq profesori universitar Valon Murati ka thënë se janë disa projekte strategjike të cilat nuk kanë çmim dhe as nuk maten me studime fizibiliteti. Sipas tij, një i tillë është edhe projekti amerikan i gazit të lëngshëm natyror (LNG)

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 MAJ - Tërheqja e Qeverisë së Kosovës nga projekti për ndërtimin e infrastrukturës së gazit të financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e Qeverisë së ShBA-së (MCC) po vazhdon të kritikohet nga partitë opozitare në Kosovë. Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë të martën se refuzimi i projektit të gazsjellësit ka qenë gabim strategjik i

Qeverisë së Kosovës. “Gazsjellësi i mbështetur nga ShBA-ja do t’i fuqizonte dhe diversifikonte resurset energjetike të Republikës së Kosovës”, ka shkruar ajo në llogarinë e vet në “Facebook”. Çitaku ka theksuar se për më tepër, në nivelin strategjik dhe gjeopolitik, ky gazsjellës është një kundërpërgjigje e drejtpërdrejtë e dominancës së gazit rus në Evropë. Edhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka kritikuar të martën qeverinë

Kurti për refuzimin e këtij projekti amerikan. “Në këtë kohë kur në Uashington DC po mbahet ngjarja më e madhe e largimit nga gazi rus me shtetet lidere në diversifikim të energjisë, Kosova nuk është aty. Albin, ku je ti? Ku është Kosova? Duhet të japësh përgjegjësi dhe llogari se pse ke refuzuar rreshtimin e Kosovës me ShBA-në”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Reagime më herët ka pasur edhe nga Lidhja Demokratike

e Kosovës (LDK). Sipas LDK-së, Qeveria e Kosovës refuzoi projektin më gjeostrategjik amerikan në Ballkan, që do t’i siguronte shtetit furnizim me gaz e, së këndejmi, edhe tranzicionin e nevojshëm energjetik. “Ecja jonë strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të jetë e përbashkët në politikë, ekonomi, siguri e energjetikë”, është thënë në reagimin e LDK-së. Profesori universitar Valon Murati ka thënë se janë disa projekte strategjike të cilat nuk kanë çmim dhe as nuk maten me studime fizibiliteti. “Një i tillë është projekti amerikan i gazit të lëngshëm natyror (LNG), thelbësor për diversifikimin e burimeve të energjisë në Evropë. Sot u bë përirimi i terminalit të LNG-së në portin grek të Alexandropolit, investim ky amerikan dhe i BE-së. Përderisa udhëheqësit e

Kosovës janë hedhur në ofensivë për ta ‘bindur’ botën kush është Vuçiqi, e kush Putini dhe cila është lidhja në mes të tyre, ky i pari sot ishte në përirimin e terminalit në Greqi. Kosova jo vetëm që po mungon, por në mënyrë krejt të papërgjegjshme qeveria jonë refuzoi të jetë pjesë e këtij projekti. Kjo vërtet është diplomaci shumë e hollë”, ka shkruar Murati në llogarinë e vet në “Facebook”. MCC-ja kishte përcaktuar një shumë deri në 200 milionë dollarë për ta ndihmuar ndërtimin e infrastrukturës së gazit. Opsioni që ishte më i studiuar për këtë projekt nga Qeveria e Kosovës është thënë se ka qenë ndërtimi i infrastrukturës së gazit, që do t’i jepte qasje Kosovës përmes Maqedonisë së Veriut. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, thotë për

Scholzi pret në Berlin Kurtin, Vuçiqin dhe Lajçakun

PRISHTINË, 3 MAJ - Sot (e mërkurë) kancelari gjerman Olaf Scholz do të presë në Berlin, në takime të ndara, kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Nga analistët kjo po shihet si një tentativë për zhbllokimin e procesit të dialogut dhe mundësi drejt arritjes së një marrëveshjeje Kosovë - Serbi. Arton Demhasaj nga organizata "Çohu", në një prononcim për "Telegrafi"-n, vlerësoi se nëse gjithçka shkon mirë nesër në Bruksel, shpejt mund të ketë një takim të nivelit të lartë Kurti - Vuçiq me ndërmjetësim të të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Sipas tij, mundësia e arritjes së një marrëveshjeje është e madhe pasi, siç u shpreh ai, në këtë proces është një inkuadrim i madh i Perëndimit. "Tentativa e kancelarit gjerman do të jetë zhbllokimi i procesit të dialogut dhe mundësia për ta arritur sa më parë marrëveshjen finale. Nëse gjithçka shkon mirë në takim e nesër, me shumë gjasë shumë shpejt mund të kemi një takim të nivelit të



lartë Kurti - Vuçiq me ndërmjetësim të Lajçakut për ta filluar raundin final të dialogut. Mundësi për të pasur një marrëveshje është e madhe për faktin se kemi inkuadrim të madh të Perëndimit në këtë proces,

sidomos të ShBA-së dhe BE-së, e tash edhe nga kancelari gjerman. Mendoj që në ditët në vijim mund të ketë lëvizje pozitive në drejtim të një marrëveshjeje", ka thënë Demhasaj. Po të mërkurën në Berlin do të

udhëtojë edhe i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Ky i fundit fillimisht do të takohet me kancelarin Scholz e pastaj do të zhvillojë takim jozyrtar të veçantë me kryeministrin

Kurti dhe presidentin Vuçiq. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u takuan për herë të parë më 15 qershor të vitit 2021 në Bruksel, në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi.

Ambasadori norvegjez, optimist për marrëveshjen finale Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 3 MAJ - Ambasadori norvegjez Jens Erik Grondahl mendon se situata në Kosovë dhe rajon është e qetë pavarësisht prej shqetësimeve në rritje pas agresionit rus në Ukrainë. Së fundmi, zyrtarët policorë kanë qenë cak i disa sulmeve të cilat ambasadori i dënoi ashpër, duke thënë se incidentet e tilla janë të papranueshme. Ambasadori Grondahl, në intervistë për "KosovaPress", flet edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe bashkëpunimin mes vendit tonë dhe Norvegjisë. "Unë shpresoj shumë dhe ne kemi nevojë për një zgjidhje për këtë situatë. Besoj se praktikisht regjimi i tiketave ngjitëse po funksionon shumë



mirë, por ne absolutisht mbështesim një marrëveshje përfundimtare për targa, por edhe për të gjitha çështjet e tjera që mbeten të zbatohen nga marrëveshjet e Brukselit. Ne do të donim të shihnim liri të lëvizjes, liri të udhëtimit, që dokumentacionet të pranohen nga të gjithë, targa e makinave gjithashtu, për sa kohë që ata përmbushin kriteret e praktikave më të mira evropiane për targa e makinave. Pra, shpresoj që së shpejti të ketë një zgjidhje për këtë problem, në mënyrë që sa më shpejt të kemi një qarkullim të lirë të mallrave, njerëzve dhe udhëtimeve. Kjo është, në fakt, shpresa jonë", ka deklaruar Grondahl.

"Radion Evropa e Lirë" se vendimi për tërheqje nga investimi në infrastrukturë të gazit ishte i ngutshëm. "Ka qenë befasi që Qeveria e Kosovës ka vendosur të heqë dorë nga projekti i tillë. Po, ndoshta, ajo që është më

inkurajuese, është se pritet të vazhdojë bashkëpunimi me MCC-në për të parë se si kjo korporatë mund të investojë në Kosovë në aspekte të tjera përmes të ashtuquajturit program kompakt", pati deklaruar Zeka.

Kostoja kapitale e investimit në infrastrukturë e gazit dhe termocentrali, i cili ishte llogaritur se mund të kushtojë deri në 600 milionë euro, ishin ndër dilemat që kishte Qeveria e Kosovës. Zeka ka thënë se asnjë shtet

partner i Kosovës e as Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta fusnin Kosovën në një pozitë të vështirë financiare. Duke u nisur nga kjo, ai thotë se projekti është dashur të vazhdojë. "Kosova ka pasur nevojë të investojë në

infrastrukturë e cila mundëson diversifikimin e burimeve të energjisë, respektivisht krijimin e infrastrukturës që do ta mundësonte bartjen e gazit natyror. Kjo do të fuqizonte kapacitete industriale", ka theksuar Zeka.

Zelensky i kërkon Shqipërisë të mos lejojë turistë e anije ruse



TIRANË, 3 MAJ - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, iu drejtua të martën deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, duke bërë thirrje për më shumë mbështetje humanitare dhe armë për Ukrainën, për të përballuar, siç tha ai, agresionin rus.

Presidenti ukrainas, duke folur përmes videolidhjes, kërkoj nga Shqipëria që t'i mbyllë portet për anijet ruse dhe ta kufizojë ardhjen e turistëve rusë. "Bankat ruse duhet të shkëputen plotësisht nga sistemi financiar global. Sado e vështirë të jetë, duhet të kufizohet qëllimisht tregtia me Rusinë. Ju kërkoj t'i mbyllni portet për anijet ruse, t'i kufizoni ardhjet për turistët rusë... ndoshta vijnë vrasës të Buçës apo të Irpinit", tha Zelensky, duke iu referuar qyteteve ukrainase, ku forcat ruse dyshohet se kanë kryer

krime të rënda.

Zelensky shprehu mirënjohje për, siç tha, mbështetjen e Shqipërisë dhe kujdesin ndaj qytetarëve të Ukrainës, që ikin nga lufta dhe strehohen në këtë vend. "Faleminderit për hapat konkretë për Ukrainën, për ndihmën e mbrojtjes, për mbështetjen kundër Rusisë, për përkujdesjen që ua jepni fëmijëve tanë, njerëzve tanë! Qëndrimi juaj ndaj popullit të Ukrainës më bën ta kujtoj Shën Terezën shqiptare, e cila është kthyer në simbolin e humanizmit në mbarë botën", tha Zelensky.

Ai tha se vendi i tij po përballet me luftë "të pamëshirshme" nga Rusia, e cila, sipas tij, po bën përpjekje "ta ringjallë një tirani të tmerrshme". "Po shohim se si ushtria ruse po qëllon fëmijët. Njerëzit e strehuar në bunkerë kanë filluar të ngrihen. Në zonat që ka çliruar Rusia, po varrosen

njerëz që janë gjetur të vvarë me duar të lidhura", tha Zelensky.

Zelensky u përshëndet me duartrokitje nga deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, të cilët mbanin para vetes pankarta me flamurin e Ukrainës dhe mbishkrimin: "Ne qëndrojmë me Ukrainën".

Rama: Historia e Kosovës na ndihmon ta ndiejmë dhimbjen e Ukrainës

Fjalën pas tij e mori kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili tha se rrallëherë ndodh që Kuvendi i Shqipërisë "të shquhet për dakordësi", mirëpo "mbështetja ndaj rezistencës ukrainase kundër pushtuesve rusë është e përbashkët". "Gjithë kombi ynë, përfshirë edhe shtetin tjetër shqiptar, Kosovën, është rreshtuar krahu me çdo gjë që

kemi mundur", tha Rama.

Ai theksoi se Shqipëria po mundohet t'i dalë në ndihmë Ukrainës në forma të ndryshme. "Shqipëria është vend shumë më i vogël se i juaji, mundësitë për ndihmë janë modeste, por kemi besuar që në fillim se, edhe pse materialisht s'mund të bëjmë gjë, mund të jemi të vlefshëm me zë në tryezat e NATO-s dhe OKB-së, ku kemi qenë bashkëpunues të rezolutave të rëndësishme kundër agresionit rus", tha Rama. Ai tha se shqiptarët bashkëndiejnë thellësisht me vuajtjet e popullit ukrainas, sepse jo shumë kohë më parë u përballën edhe vetë me luftë. "Edhe pse mizorinë e kësaj lufte nuk mund ta perceptojë sa e si duhet askush tjetër, përveç popullit ukrainas, më lejoni t'ju them, i nderuar president Zelensky, se historia jonë e afërt - kur gjysmë milioni shqiptarë u

shpërngulën me dhunën e spastrimit etnik nga trojet e tyre në Kosovë dhe gjetën strehë në Shqipëri - na ndihmon të ndiejmë nga larg dhimbjen e madhe të Ukrainës", u shpreh Rama.

Shqipëria, anëtare e NATO-s që nga viti 2009, është rreshtuar me këtë aleancë ushtarake dhe me Bashkimin Evropian në mbështetjen e Ukrainës, duke vendosur sanksione kundër Rusisë, si dhe duke kontribuar në koordinimin politik në NATO dhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për ta dënuar pushtimin rus. Autoritetet shqiptare, gjithashtu, e kanë përkrahur rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që dënon pushtimin rus të Ukrainës dhe, së voni, kanë ndërmarrë një iniciativë për dokumentimin dhe hetimin e krimeve të luftës në Ukrainë përmes OKB-së.

Berisha konfirmon kandidaturën për kreun e PD-së: Nuk kam rivalë

TIRANË, 3 MAJ - Ish-kryeministri Sali Berisha e ka quajtur "lojë me kukulla" takimin e ndihmës-sekretares së Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatik, Karen Donfried, me Alibeajn, Tabakun dhe Bardhin.

Këtë të martë, në një konferencë për medie, Berisha tha se përpjekjet e ShBA-së nuk do të mund t'i caktojnë kryetarin forcës demokratike të Shqipërisë. "Po kthehem në dhjetor, Eskobari takoi Lulzim Bashkën dhe fiksoi një takim në Uashington me të. Kësaj here takuan pasardhësin e Bashës. Loja me kukulla nuk është serioze dhe nuk funksionon në



Shqipëri. Përpjekja ku e majta e ShBA-së dhe mbarë botës nuk do të mund t'i caktojë kryetarin forcës demokratike të Shqipërisë, pastaj të tjerat janë çështje protokollesh", ka thënë Berisha. Ndihmës-sekretarja e Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike, Karen Donfried, nuk e takoi drejtuesin e Komisionit të Rithemelimit në PD, Sali Berishën, javën që lamë pas, dhe shkak për këtë pranoi se ishte 'non grata' që ShBA-ja i ka shpallur ish-kryeministrit. Donfried takoi gjatë vizitës së saj zyrtare në Tiranë kreun e komanduar të PD-së, Enkelejd Alibeajn, Jorida Tabakun dhe

Gazment Bardhin, duke shmangur grupin e Rithemelimit. Pasi Komisioni i Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale shpalli afatin zyrtar për ta dorëzuar dokumentacionin, Berisha tha se do t'i respektojë rivalët në garë dhe theksoi se ka marrë fund koha e shpikjes së rivalëve. "Cilido që të kandidojë, e garantoj që ai komision do të krijojë kushtet për një garë të hapur dhe të ndershme. Nuk ka rivalë. Ka marrë fund koha kur Edi Rama shpikte rivalë për veten e tij. Këto kërkojini atje. Me Sali Berishën nuk ka kështu. Nuk shpik, por respektoj rivalin", ka thënë Berisha.

Gati 5 miliardë euro kursime në Kosovë: Ku shkojnë këto para?

PRISHTINË, 3 MAJ - Vlera e depozitave të klientëve në dhjetë bankat komerciale të Kosovës ka arritur në mbi 4.9 miliardë euro. Nga kjo vlerë, më shumë se 3.3 miliardë euro janë depozita të qytetarëve, ndërsa pjesa tjetër u takon ndërmarrjeve.

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, vlera e depozitave në vitin 2021 ka shënuar rritje për 12.4 për qind në krahasim me vitin 2020.

Më saktësisht, sipas BQK-së, vlera e depozitave të reja, të arkëtuara vitin e kaluar, ka arritur në 446.1 milionë euro. Nga Shoqata e Bankave në Kosovë thonë se pjesa më e madhe e depozitave - mbi 76 për qind - është shfrytëzuar nga bankat për kreditim të ekonomisë.

Deri në fund të vitit 2021 vlera e përgjithshme e kredive të dhëna nga bankat ka arritur në 3.75 miliardë euro. "Ruajtja e raportit ndërmjet kreditimit dhe depozitës është e rëndësishme meqë tregon për shëndetin e sektorit bankar, i cili ka qenë vazhdimisht i kujdesshëm në pjesën e kreditimit përmes ruajtjes së likuiditetit në nivele të pranueshme, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare", thuhet në një deklaratë me shkrim të Shoqatës së Bankave të Kosovës, dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Albulenë Kastrati, profesoreshë e ekonomisë në Kolegjin AAB në Prishtinë, thotë se do të ishte më mirë që kursimet të shpenzoheshin apo investoheshin në biznese apo patundshmëri e jo të mbahen si para të gatshme në banka. Por, sipas saj, për këtë mungojnë platformat investuese. "Natyrish, mungon [edhe] edukimi financiar i popullatës për t'i shfrytëzuar këto depozita në formë të investimeve", thotë Kastrati. Ajo shton se norma e interesit në depozita vitet e fundit ka rënë shumë dhe, si e tillë, nuk siguron kthim të dinjitetshëm të depozitarët.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara në sektorin bankar gjatë



periudhës janar-dhjetor 2021 ka qenë 1.3 për qind, ndërsa norma e interesit për kreditë e marra sillet në rreth 5.8 për qind.

Çka ndikoi në rritjen e depozitave?

Nga Shoqata e Bankave e Kosovës thonë se rritja e vlerës së depozitave dëshmon besimin e qytetarëve në sektorin bankar. Sipas kësaj shoqate, në rritjen e vlerës së depozitave ka ndikuar performanca më e mirë e bizneseve pas lirimit të kufizimeve që ka imponuar pandemia Covid-19, por edhe tërheqja e kursimeve nga Trusti Pensional.

Në vitin 2020 qytetarëve të Kosovës u është dhënë mundësia për të tërhequr 10 për qind të kursimeve në Trust për t'i përballuar më lehtë vështirësitë ekonomike që mund t'u kishte shkaktuar pandemia. Atëbotë nga Trusti janë tërhequr afro 200 milionë euro.

Edhe sipas një raporti të Institutit për Hulumtime të Avancuara GAP në Kosovë, 40 për qind të rritjes së depozitave i kanë nxitur kursimet e nxjerra nga Trusti, që janë deponuar në llogari private dhe nuk janë shpenzuar menjëherë. Përgjegjës për sigurimin e kursimeve në Kosovë është Fondi i Sigurimit të Depozitave. Ky fond, që është krijuar në vitin 2011,

punon për t'i mbrojtur depozitorët nga humbja në rast të revokimit të licencës apo mbylljes së ndonjë banke.

Gjendja ekonomike e qytetarëve në shifra

Paga mesatare bruto në Kosovë llogaritet të jetë rreth 460 euro. Paga mesatare bruto në sektorin publik është rreth 620 euro, ndërsa në sektorin privat rreth 380 euro. Sipas të dhënave të muajit shkurt të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, më shumë se 25 000 familje me 102 333 anëtarë kanë marrë asistencë sociale nga buxheti i shtetit të Kosovës. Kjo

asistencë u jepet familjeve me kushte të vështira financiare dhe që nuk kanë asnjë anëtar të punësuar.

Sipas të dhënave zyrtare, shkalla e papunësisë në Kosovë në vitin 2021 ka qenë afro 26 për qind.

Të dhënat e fundit të Bankës Botërore për varfërinë në Kosovë janë të vitit 2017 dhe, sipas tyre, mbi 23 për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë në varfëri.

Në Kosovë pothuajse të gjitha produktet e konsumit janë shtrenjtuar dukshëm që nga viti i kaluar. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni në muajin mars në Kosovë është rritur për 10 për qind krahasuar me muajin mars të vitit 2021.

Azemi: Kjo qeveri nuk do dialog



PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka thënë se qeveria nuk do dialog dhe se pa të nuk ka rezultat dhe as perspektivë. Azemi ka thënë në emisionin "Sot" të KTV-së të martën, se punëtorët e sektorit privat, në 80 % të rasteve më lehtë merren vesh me punëdhënësit sesa me qeverinë pasi, siç ka thënë, mungesa e punëtorëve po e bën efektin e vet. "Me pronarë të kompanive në 80 % të rasteve problemet kur na lindin, i zgjidhim.

Mungesa e punëtorëve po e jep efektin e vet. Një e keqe e kësaj qeverie është që nuk do dialog dhe në momentin që nuk do dialog, nuk ka rezultat dhe as perspektivë. Ne po e bëjmë gjithë të mundur që të ulemi të bisedojmë", ka thënë Azemi.

Ai ka folur edhe për pagën minimale prej 264 eurosh të propozuar nga qeveria. Sipas tij, vendit i duhet një pagë minimale prej 460 eurosh për t'i përmbushur nevojat elementare të jetës marrë parasysh rritjen e madhe të çmimeve të ushqimeve.



Katër rastet kur gabimet e vogla e ndryshuan botën

Gabimet ndodhin kudo dhe shumë herë gjatë historisë. Por disa janë më të spikatura se të tjerat. Ju vetë mund të keni bërë një duzinë gabimesh javës që kaloi, të parëndësishme apo edhe disi serioze. Por shumica e gabimeve tona nuk na e ndryshojnë jetën. Vetëm disa prej tyre, mund të arrijnë të kenë një ndikim shumë të madh në jetën tonë personale. Por përgjatë historisë kanë ndodhur disa gabime, që e ndryshuan botën siç e shohim sot.

1. Kur holandezet nuk e deklaruan se kishin zbuluar Australinë

Kapiteni anglez Xhejms Kuk nuk ishte i pari që e zbuloi Australinë. Një shekull para tij, në vitin 1606, kapiteni holandez Vilem Janzon u nis me anijen e tij "Duyfken" dhe eksploroji mbi 200 milje vijë bregdetare në pjesën perëndimore të gadishullit Kejp Jork, duke u bërënjeriu i parë që zbuloi kontinentin e Australisë për evropianët.

Shumë holandezë të tjerë eksploruan brigjet perëndimore dhe jugore të së njëjtës zonë, dhe e quajtën atë Holanda e Re. Megjithatë, ata nuk bënë asnjë përpjekje për të

kolonizuar atë zonë apo për t'u krijuar atje ndonjë vendbanim të qëndrueshëm. Për këtë arsye, zbulimi i tyre mbeti i harruar për një kohë të gjatë derisa Kapiteni Kuk shpalli pretendimin e tij në vitin 1770.

2. Lufta me vetveten e ushtrisë austriake

Kur shpërtheu Lufta Austro-Turke e vitit 1788 midis osmanëve dhe habsburgasve, ndodhi një moment një incident i rëndë në radhët e trupave austriake. Ai incident i dha osmanëve një epërsi të papritur. Në shtatorin e atij viti, austriakët kaluan një lumë për të spiunuar armikun në anën turke.

Por ata nuk mundën të dallonin askënd. Në vend të tyre, gjetën re disa vendas që po shisnin verë. Disa trupa të ushtrisë austriake blenë pije alkoolike duke u dehur. Në anën tjetër të lumit, komandanti austriak po i priste me durim në kamp që të ktheheshin me informacione të rëndësishme mbi osmanët.

Kur trupat nuk po ktheheshin, komandanti dërgoi disa oficerë për t'i kërkuar. Nuk kaloi shumë kohë dhe ushtarët e dehur u zbuluan, dhe më pas ndodhi një kaos i madh. Dy grupet e ushtarëve besuan se grupi

tjetër ishte nga anën e armikut. Një oficer i artilerisë e vëzhgoi përplasjen nga një distancë e largët, dhe mendoi se kampi austriak ishte nën sulm, ndaj ai urdhëroi ushtarët e tij të hapnin zjarr, duke vrarë mbi 1000 ushtarë. Kur osmanët mbërritën në vendngjarje, gjetën shumë viktima nga ushtria austriake, dhe e morën pa asnjë luftë Karansebes.

3. Kur Rusia ia shiti Alaskën Shteteve të Bashkuara

Kur shpërtheu Lufta e Krimesë në vitin 1853, Turqia, Britania e Madhe dhe Franca luftuan kundër armikut të tyre të përbashkët, Rosisë. Gjatë kësaj periudhe, gjërat u ndërlikuan shumë për Perandorinë Ruse, e cila nuk mund të kujdesej dot më për rajonin e Alaskës.

SHBA-ja i erdhi në ndihmë. Pavarësisht kritikave që nxiti ai vendim, në marsin e vitit 1867 u nënshkrua një marrëveshje, sipas së cilës Rusia ia shiti Alaskën SHBA-së për shumën 7.2 milionë dollarë. Jo shumë më vonë, gjatë viteve 1880–1890, minierat e arit në këtë rajon isollën SHBA-së miliona dollarë të ardhura, duke i dhënë një shtytje të fuqishme ekonomisë së saj.

4. Kur Aleksandër Flemingun nuk mundi ta mbante dot pastër laboratorin e tij

Që nga zbulimi i paprecedentë i penicilinës nga Aleksandër Fleming në vitin 1928, fusha e mjekësisë nuk ka qenë më e njëjta. Edhe pse shkencëtarët e cilësojnë këtë të fundit si një njeri revolucionar të shkencës, ai që supozohej të ishte një zbulim domethënës, ishte në fakt një gabim, edhe pse një gabim i shkëlqyer.

Pasi Fleming u kthye nga pushimet e tij të shkurtra, vuri re se një nga pjatat e tij laboratorike me baktere stafilokok, po shfaqte shenja të rritjes së kërpudhave. Ndërsa kërpudhat u përhapën, ato i asgjësuan bakteret në pjatë.

I nxitur nga ky vëzhgim i çuditshëm, Fleming i kultivoi kërpudhat në një pjatë të pastër, gjë që konfirmoi edhe zbulimin e tij fillestar. Fleming e quajti substancën që prodhoi kërpudhat si "lëngu i mykut", që vepronte si antibiotik kundër kulturës bakteriale. Ky "lëng myku" u përdor gjerësisht gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ndihmoi në shpëtimin e jetës së shumë të ushtarëve dhe civilëve të plagosur. / History of Yesterday – Bota.al

Çfarë i nxit ushtritë të kryejnë masakra ndaj popullatave civile?

Nga Bret DEVEREAUX

Ndërsa tërheqja e forcave ruse nga Ukraina Veriore po zbulon prova të ekzekutimeve masive të civilëve në zona si Bucha, një rëndësi të madhe ka marrë pyetja se çfarë i nxit ushtritë të kalojnë në brutalitetin e krimeve të luftës dhe masakrave.

Nuk është ende e qartë se cilat nga mizoritë në Ukrainë janë urdhëruar nga lart, siç sugjerojnë raportet mbi listat e zeza që kishin përpiluar rusët, dhe cilat janë urdhëruar nga komandantët lokalë apo janë kryer nga ushtarë ose grupe të veçanta.

Në luftë, kjo e fundit ndodh shpesh për shkak të lejimit në mënyrë të heshtur të elitave. Edhe pse të gjitha luftërat përfshijnë në një farë mase akte brutale, disa ushtri, siç janë forcat aktuale ruse, janë shumë më të prirura për të kryer mizori. Në thelb të gjitha luftërat për nga natyra e tyre, kanë në përmbajtje një masë mizorie.

Siç vinte në dukje gjenerali prusian Karl Von Klauzevic, nga vetë natyra e saj lufta si një akt force e shtyn secilën palë në ekstreme brutaliteti. Por për disa ushtarakë, aktet e dhunës kundër civilëve dhe krimet e tjera të luftës janë devijime, pra momente kur brutaliteti i natyrshëm i luftës i thyen barrierat institucionale dhe kulturore të krijuara për t'i drejtuar dhe kontrolluar ata.

Ushtarët e tjerë duken të paafte për të ndihmuar veten e tyre, duke masakruar civilët kudo që të shkojnë, edhe pse duke bërë vazhdimisht diçka të tillë ata dëmtojnë qëllimet e tyre të përgjithshme strategjike.

Historianët e së kaluarës së afërt

dhe asaj të lashtë, kanë identifikuar modele të qarta se cilat lloje të ushtrive degradojnë plotësisht në brutalitetin e luftës. Mizoritë nuk ndodhin thjesht, dhe as nuk janë tipike për ndonjë vend të caktuar. Përkundrazi, ato janë produkt i kulturës organizative, vendimeve komanduese dhe i një strukture institucionale, e cila e mbron një ushtri nga kontrollat civile ose përgjegjësia.

Një nga faktorët që mund ta nxisë prirjen e një ushtaraku drejt masakrave, është disiplina brutale brenda organizatës ushtarake. Dhuna e ushtruar rregullisht nga lart poshtë, verbale dhe fizike, dhe ushtarët si viktima të saj shfryjnë dufin ndaj civilëve të pafajshëm.

Ushtria Perandorake Japoneze është një rast i tillë. Trajnimi dhe sjellja shumë e dhunshme dhe represive ndaj rekrutëve, ishte e tillë sa sipas historianit japonez Saburo Ienaga "dinjiteti dhe burrëria e ushtarëve ishte çenuar aq keq, sa që vështirë se ata do të përmbaheshin nga të bërit të njëjtën gjë ndaj personave të pambrojtur".

"Tek e fundit, ata thjesht po zbatonin atë që kishin mësuar në trajnimin bazë" - thekson ai. Kultura organizative e ushtrisë japoneze në atë kohë e vine theksin tek një shkallë të lartë të "e distancimit të pushtetit" midis eprorëve dhe vartësve, ku rekrutët i nënshtroheshin një trajtimi shumë të ashpër.

Dhe kur ata u vendosën në një pozicion pushteti mbi civilët e paarmatosur, përsëritën të njëjtin model me pasoja katastrofike. Historiana Izabel Hull dokumenton një dinamikë të ngjashme brenda Ushtrisë Perandorake Gjermane. Vënia e theksin tek "kadavergehorsam",

ose "bindja si një kufomë ndaj eprorit", lindi nga përpjekja për t'i dhënë fund kaosit të pashmangshëm të operacioneve ushtarake, nëpërmjet një rendi ekstrem të imponuar nga dhuna.

Kjo u zgjerua në një "pritshmëri jorealiste të rendit të përsosur" në zonat e pushtuara që kur dështoi në mënyrë të pashmangshme, u përforcua nga raprezaljet dhe ndëshkimet brutale, të justifikuara si domosdoshmëri ushtarake, madje edhe kur dhuna u përshkallëzua në një shkallë të tillë sa që dëmtoi edhe vetë objektivat ushtarake.

E njëjta dinamikë mund të vërehet edhe në Spartën e lashtë. Sistemi spartan për rritjen e djemve qytetarë, agoge (program i rreptë trajnimi), ishte një ritual ku djemtë liheshin qëllimisht pa ngrënë, por rriheshin fort nëse kapeshin, dhe detyroheshin të disiplinonin me dhunë djemtë më të vegjël.

Dhe rezultati ishte se jashtë Spartës, spartanët iu drejtuan dhunës si ndaj miqve po ashtu edhe ndaj armiqve, duke e çuar hegemoninë spartane në kolaps që para se të fillonte, pasi udhëheqja brutale dhe e paafte spartane, e modeluar sipas jetës në agoge, u armiqësua si me aleatët ashtu edhe me armiqët. Megjithatë kultura organizative midis ushtarëve është qartazi një faktor ndikues, më vendimtare janë vendimet e komandës dhe rrjedhimisht edhe kultura strategjike midis oficerëve. Ushtritë e prirura për mizori, nuk janë pasojë e ushtarëve të padisiplinuar që u dalin nga kontrolli oficerëve të tyre, por më tepër i ushtarëve të bindur që ndjekin komandat brutale të

oficerëve të tyre.

Hull e dokumenton shumë mirë këtë cikël, për shembull në shtypjen brutale të gjermanëve ndaj popullit Herero në Afrikën Jugperëndimore (1904-1907), në Namibinë e sotme. Zhgënjimi nga dështimi i ushtrisë gjermane për të arritur një fitore vendimtare dhe përfundimtare në Vaterberg (gusht 1904), çoi në brutalitet të përshkallëzuar kur komandanti Lotar Von Trota, autorizoi zbatimin e një politike të shfarosjes në masë. Së fundi, ushtritë e prirura për masakra priren të mos kenë kontrollë të jashtme efektive mbi kulturën apo sjelljen ushtarake. Ushtria Perandorake dhe Marina Japoneze e përmbysën kontrollin civil përmes një sërë atentatesh dhe përpjekjesh për grusht shteti në vitet 1930. Ndaj ushtria ishte në gjendje të niste edhe luftëra të mëdha pa një mbikëqyrje efektive nga administrata civile.

Po kështu, edhe Ushtria Perandorake Gjermane ishte siç vëren Hull, kryesisht e mbrojtur nga mbikëqyrja civile nga struktura politike e Perandorisë Gjermane, e cila e zvogëloi ndikimin e Rajhstagut mbi ushtrinë kryesisht përtej ndikimit të Rajhstagut.

Elementë të të njëjtit model janë të dukshëm edhe tek Forcat e Armatosura Ruse. Para kësaj lufte, ka qenë i mirë-dokumentuar problemi i ngacmimit dhe dhunës ndaj rekrutëve në ushtri, një dukuri e njohur si "dedovshchina". Po ashtu vendimet e komandës ruse krijuan një strukturë të qartë lehtësuese për akte të mëtejshme brutale.

Që përpara pushtimit, intelijenca amerikane paralajmëroi se forcat ruse kishin

një "listë të zezë" për ukrainasit që do të vriteshin ose do të dërgoheshin në kampe, përfshirë gazetarët, aktivistët dhe minoritetet. Krematoriumet e lëvizshëm në një pushtim që ata prisnin të ishte i shpejtë dhe relativisht i lehtë, tregojnë për shkallën e vrasjeve që kishin ndërmend të kryenin pas pushtimit.

Ndërkohë, kultura e brendshme e ushtrisë ruse dhe krenaria e vendit në axhendën ideologjike të Putinit, e bëjnë atë imun ndaj kritikave efektive ose mbikëqyrjes civile. Forca e vetme që e monitoron ushtrinë janë shërbimet e sigurisë, të cilat janë të përkushtuara ndaj besnikërisë ndaj Putinit dhe jo ndaj respektimit të ligjeve të luftës.

Ashtu si me shembujt e mësipërm, sjellja mizore është bërë një normë tashmë për ushtrinë ruse, nga Çeçenia në Siri, dhe tani edhe në Ukrainë. Ashtu si gjermanët në Afrikën Jugperëndimore, kur ngeci përparimi i rusëve dhe u zbeh perspektiva e një fitoreje të shpejtë dhe vendimtare, komandantët rusë reagues përmes përshkallëzimit të brutalitetit duke bombarduar qendrat urbane me bomba thërrmuese dhe me armë të tjera të rënda.

Por siç e ka treguar shpesh historia, edhe masakrat ruse ndaj civilëve në Ukrainë, do të jenë ushtarakisht joefektive. Ato do ta forcojnë vendosmërinë e Ukrainës për të rezistuar, dhe vendosmërinë ndërkombëtare për të vendosur sanksione të reja ndaj Rusisë dhe për ta mbështetur Ukrainën.

Shënim: Bret Devereaux, është një historian i specializuar mbi ekonominë dhe ushtrinë romake. /"Foreign Policy"- Bota.al



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Liverpooli kualifikohet në finale

VILLARREAL, 3 MAJ - Nisje si në ëndrra ajo e Villarrealit, që ia doli të ndëshkonte skuadrën e Liverpool që në minutën e tretë me Dia, i cili brenda zone nuk fali. "Nëndetësja e verdh", e motivuar nga tifozët dhe goli, vijoi të sulmonte. Dani Parejo dhe Gerard Moreno më pas bënë me zemër skuadrën e Jurgen Klopp, por nuk shënuan dot golin e dytë. Në minutën e 37-të Lo Celso përfundoi në tokë dhe vendasit

pretenduan penalti, por nuk ishte i atij mendimi arbitri i ndeshjes. Villarreal gjithsesi ia doli ta mbyllte pjesën e parë me festë, pasi Couquelin e dërgoi topin në rrjetë me një goditje me kokë dhe spanjollët nisën të besojnë te mrekullia. Sigurisht ndaj Liverpool nuk mund të jetë kurrë e lehtë. Pjesa e dytë është totalisht e Liverpoolit, ku në minutën e 62-të, Salah asiston për Fabinhon dhe braziliani e dërgon topin në

këmbët e portierit. Vetëm pesë minuta më pas, në minutën e 67-të, Luis Diaz merr një top nga Alexander Arnold dhe më pas finalizon golin e barazimit. Por nuk u mjaftua me kaq ekipi anglez, pasi në të 74-tën Mane përfiton nga një dalje e gabuar e portierit të Villarrealit dhe shënon duke vulosur gjithçka. Për Liverpoolin kjo është finalja e dhjetë në turneun prestigjioz të Ligës së Kampionëve.



Nuhju dhe Muja paralajmërojnë fitore kundër Gjilanit

GJILAN, 3 MAJ - "Vetë fjala derbi do të thotë që është një ndeshje e veçantë, e rëndësishme për moralin e skuadrës dhe shume ndeshje speciale për tifozët tanë", ishin fjalët e trajnerit të Dritës, Ardian Nuhiu, në konferencën për media para derbit lokal, SC Gjilani - FC DRITA. Strategu i skuadrës së Dritës e ka vlesuar undërshtarin e radhës, por premtom maksimumin për të arritur fitore. "Na pret një skuadër me eksperiencë, ka futbollistë cilësorë dhe këtë vit vështirë është thyer apo ka humbur. Sot te skuadra ime kam parë motiv të veçantë për këtë ndeshje, sepse duan ta fitojnë dhe t'i bëjmë krenarë tifozët tanë 'Intelektualët', për të cilët e



dimë sa ka vlerë kjo ndeshje. Duhet të bëjmë maksimumin dhe me të gjitha forcat dhe futbollistët që kemi në dispozicion

duhet t'i përdorim e të dalim fitues", ka thënë Nuhiu. "Mëkat që ky derbi i rivalizuar të zhvillohet në një ambient të tillë pa

tifozë, do të ishte shumë e bukur të lozim me tifozë pavarësisht klasifikimit do të ishte një spektakël në tribuna dhe në fushë, sepse të dyja skuadrat kanë futbollistë shumë cilësorë. Do të mundohemi të bëjmë maksimumin dhe t'i bëjmë krenarë tifozët tanë", ka shtuar Nuhiu. Ndërsa, futbollisti Arbno Muja ka deklaruar se vetëm fjala derbi është motiv i ndeshjes dhe pret që pavarësisht mungesës së tyre fizike, t'i gëzojnë tifozët nga larg. "Vetëm fjala derbi për ne është motiv në këtë ndeshje. Kemi pasur mjaftueshëm kohë ta përgatisim ndeshjen dhe mendoj se jemi përgatitur aq mirë që nesër të dalim me rezultat pozitiv. Tifozët

SUERLIGA - JAVA E 33

Të mërkurën takohen:
 15:00 Prishtina - Feronikeli
 15:00 Gjilani - Drita
 15:00 Dukagjini - Ulpiana

Të enjten takohen:
 15:00 Drenica - Llapi
 15:00 Ballkani - Malisheva

"Intelektualët" janë motiv shtesë, ata janë fuqia jonë dhe lojtari ynë i 12-të. Mendoj që është një vendim pak i padrejtë në këtë rast dhe mungesë e madhe, por ky vendim nuk është në kompetencën tonë. Prandaj, shpresoj që nesër t'i gëzojmë me fitore edhe pa praninë e tyre në stadium", ka thënë Muja.

Norwichi e nxjerr në shitje Rashicën



NORWICH, 3 MAJ - Norwich City ka rënë nga elita e futbollit anglez vetëm pas një viti qëndrim në Ligën Premier. Skuadra angleze ka humbur statusin e ekipit elitari katër xhiro para fundit të edicionit. Në 34 sfida sa kanë zhvilluar deri më tani Norwich ka arritur pesë

fitore, gjashtë barazime e 23 disfata. Norwich ka sulmin më të dobët në ligë me 22 gola të shënuar, derisa mbrojtjen e dytë më të dobët me 71 gola të pësuar. Tanimë të rënë nga elita e futbollit anglez, Norwich do t'i largojë shumicën nga yjet e skuadrës. "The Sun" ka raportuar se te

Norwichi do të largohen lojtarët më të paguar në klub pasi nuk duan t'i mbajnë ata në Championship ku niveli i pagave është më i ulët. Në mesin e lojtarëve që do të largohet nga Norwichi është edhe reprezentuesi kosovar Milot Rashica, i cili këtë edicion shënoi një gol e

dhuroi dy asistime në Ligën Premier. Norwich pagoi 11 milionë euro për transferimin e tij në Angli nga Werder Bremen, derisa e ardhmja e Rashicës mund të jetë përsëri në elitën e futbollit gjerman ku vushtriasi pëlqehet nga shumë skuadra.


Vëmendja në Prizren

PRIZREN, 3 MAJ - Sot (e mërkurë) zhvilloja sfida e tretë çerekfinale të "play-off"-it mes Prizreni 16 dhe Sigal Prishtinës, që do të vendosë se kush do të kualifikohet në

gjysmëfinale. Në takimin e parë fitore shënuan prizrenasit 95:87, kurse në ndeshjen e dytë prishtinasit 98:89. Kjo përballje është vendimtare për kualifikim,

ndërsa në gjysmëfinale i pret Golden Eagle Ylli, që përfundoi garat në vendin e parë. Në garat e rregullta, të dy skuadrat kishin nga 15 fitore e 13 humbje, ndërsa në

ndeshjet direkte mes tyre, prizrenasit kishin tri fitore, ndërsa një i takoi prishtinasve. Ndeshja zhvillohet të mërkurën mbrëma në Prizren nga ora 20:30.





NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS SHËRBIME

Sipas Nenit 41 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 29/04/2022

Nr i Prokurimit	Transporti	001	2022	221
-----------------	------------	-----	------	-----

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip

ENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Shqiptarët Humanitarë Bëmërisë e Kosovës "Nëna Tereza"		
Adresa Postare: Mujë Krasniqi Ulpiana U1/1		
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Zef Shala	Telefoni: 044-128-277	
Email: zefshala@hotmail.com	Faksi: 038-542-869	
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		www.mothersociety.org

Kontrata përshtetë prokurimin e përbashkët Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Jo

ENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Shërbime të transportit Ndërkombëtar	
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime - e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)	
<input type="checkbox"/>	Shërbime
	Vendi kryesor i realizimit Sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues ORADEA Hungari
II.1.3) Njoftimi përfshinë, nëse aplikohet Kohëzgjatja e marrëveshjes kornizë: në muaj 30 ditë (një muaj)	
II.1.4) Përshkrimi i shkurtër i lëndës së kontratës Transporti i ndihmave Humanitare për nevojat e popullatës së Ukrainës të qvendosur në Rumani	
II.1.5) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP) 60.00.00.00-8	
II.1.6) Ndarja në pjesë	Jo <input type="checkbox"/>
II.1.7) Vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00 Euro	

ENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

E hapur

III.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

III.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë
Njoftimi për kontratë

SECTION IV: DHËNIA E KONTRATËS

(Në rast të disa pjesëve të dhëna disa operatorëve ekonomik të suksesshëm, përsërit S IV.4 dhe IV.5 për secilën pjesë)

IV.1) Data e dhënies së kontratës 29/04/2022		
IV.2) Data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës 04/05/2022		
IV.3) Numri i tenderëve të pranuar 2		
IV.4) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, të cilit i është dhënë kontrata		
Emri zyrtar: AGRO-AB SHPK Graçanicë		
Adresa Postare: Qagllavicë-Graçanicë		
Qyteti: Graçanicë	Kodi postar: 10000	Vendi: Xhemi Shija Qagllavicë
URL (nëse aplikohet):		
Personi kontaktues: Alush Bendi	Email:	
Telefoni: 00381603630163	Faksi:	

IV.5) Informacione mbi vlerën e kontratës

Vlera e përgjithshme e kontratës 15,000.00 Euro

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët: 15,000.00 Euro

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lartë: 16,000.00 Euro

IV.6) A ka gjasa që kontrata të nënkontraktetohet Jo

IV.1) Data e dhënies së kontratës 29/04/2022		
IV.2) Data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës 04/05/2022		
IV.3) Numri i tenderëve të pranuar 2		
IV.4) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, të cilit i është dhënë kontrata		
Emri zyrtar: AGRO AB SHPK		
Adresa Postare: Qagllavicë Xhemi Shija		
Qyteti: Graçanicë	Kodi postar: 10000	Vendi Qagllavicë- Graçanicë
URL (nëse aplikohet):		
Personi kontaktues: Alush Bendi	Email:	
Telefoni: 00381603630163	Faksi:	
IV.5) A ka gjasa që kontrata të nënkontraktetohet Jo <input type="checkbox"/>		

SECTION V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për dhënie të kontratës.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shtu informacione tjera:

Shtojce: Kopja e deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve

Formulari Standard: "Njoftimi për dhënie të kontratës"

3

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Violeta Gashi shpall të pavlefshme diplomën, tri dëftesat e notave të SH.M.M. "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë, si dhe Licencën e Punës të Lëshuar nga MSH-ja, me nr. KO-24474-05-22.
- ▶ Besim Fazliu shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLT :Arkitekt SINANI".
- ▶ Suela Dibrani shpalle te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Jusuf Rexha".
- ▶ Gresa Roka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e Sh.F.M.U 'Yll Morina' nga klasa -VI-IX.
- ▶ Halil Sylejmani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810345274 .
- ▶ Edmond Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- ▶ Suhejb Ibra shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Eqrem Çabej" nga klasa 6-9.
- ▶ Zymer Morina shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Ergin Karaali shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Kadri Hoxha shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Valjeta Thaqi shpall te pavlefshme diplomën SHME " Ymer Prizreni" Prizren.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Driton Musliu shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit të I dh te VI te SHMLT "ARKITEKT SINANI".
- ▶ Fahri Ibishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Driton Musliu shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit të II dhe të III dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients


[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues